

VENDIM
Nr. 742, datë 9.9.2015

PËR FUNKSIONIMIN DHE MENAXHIMIN E REGJISTRIT TË SHKARKIMIT E TË TRANSFERIMIT TË NDOTËSVE, MIRATIMIN E LISTËS SË VEPRIMTARIVE DHE TË NDOTËSVE, QË JANË SUBJEKT I KËTIJ REGJISTRI, SI DHE TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT TË TË DHËNAVE PËR SHKARKIMET DHE PËR TRANSFERIMIN E NDOTËSVE NGA OPERATORI¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Ky vendim krijon regjistrin e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve në Republikën e Shqipërisë (më poshtë referuar “RSHTN”), në formën e një baze të dhënash elektronike publike, për të lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, me qëllim parandalimin dhe uljen e ndotjes së mjedisit.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10448/2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

a) “Burim i shpërndarë”, disa burime të vogla ose të përhapura, të cilat shkarkojnë ndotës në tokë, ajër ose ujë, ndikimi i kombinuar dhe kumulativ i të cilave është i konsiderueshëm dhe tejkalon normat e shkarkimeve;

b) “Impiantit”, një ose më shumë instalime në të njëjtën vendndodhje dhe me të njëjtin operator;

c) “Ndotës”, një substancë ose një grup substancash që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut, për shkak të vetive dhe të shkarkimit të tyre në mjedis;

ç) “Transferime jashtë territorit të impiantit”, lëvizja e mbetjeve përtej kufijve të impiantit, të destinuara për rikuperim ose asgjësim, si dhe lëvizja e ndotësve në ujërat e ndotura, të destinuara për trajtim;

d) “Ujëra të ndotura”, ujërat e ndotura industriale, shtëpiake, urbane dhe uji i përdorur industrial, sipas përcaktimeve në legjisllacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore;

dh) “Vendndodhje”, pozicioni gjeografik i impiantit;

e) “Viti i raportimit”, viti kalendarik për të cilin duhet të mblidhen të dhëna për shkarkimin e ndotësve dhe transferimin e tyre jashtë impiantit.

KREU II
PËRMBAJTJA, KRIJIMI DHE STRUKTURA E RSHTN-së

1. RSHTN-ja përmban informacion, për:

a) shkarkimet e ndotësve, sipas përcaktimit të pikës 1/a, kreu III, të këtij vendimi, të cilët raportohen nga operatori i instalimit që kryen veprimtari sipas përcaktimit të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në vijim referuar si “operatori i instalimit”;

b) transferimet e mbetjeve jashtë territorit të impiantit, sipas përcaktimit të pikës 1/b, kreu III, të këtij vendimi, dhe të ndotësve në ujërat e ndotur, sipas përcaktimit të pikës 1/c, kreu III, të këtij vendimi, të cilët raportohen nga operatorët e impianteve që kryejnë veprimtari sipas përcaktimit të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) shkarkimet e ndotësve nga burime të shpërndara, sipas përcaktimit të pikës 1, kreu IV, të këtij vendimi, kur ky informacion është i disponueshëm.

¹ Ky projektvendim transponon pjesërisht Rregulloren EC/166/2006 mbi Regjistrin Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, amenduar me Rregulloren EC/596/2009.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) krijon, mban dhe publikon RSHTN-në, duke i paraqitur të dhënat, si në formë të agreguar, ashtu edhe në formë jo të agreguar, në mënyrë që shkarkimet dhe transferimet e ndotësve të mund të kërkohen dhe të identifikohen, sipas:

a) shërbimit, duke përfshirë kompaninë mëmë të impiantit, në rastet kur është e zbatueshme, si dhe vendndodhjen e tij gjeografike, përfshirë këtu edhe basenin e lumit;

b) veprimtarisë;

c) ndotësit ose mbetjeve, sipas rastit;

ç) përbërësit mjedisorë (ajër, ujë, tokë), në të cilët ndotësi është shkarkuar;

d) transferimeve të mbetjeve jashtë territorit të impiantit dhe të destinacionit të tyre, sipas rastit;

dh) transferimeve të ndotësve në ujëra të ndotura jashtë territorit të impiantit;

e) burimeve të shpërndara të ndotësve;

ë) pronarit ose operatorit të impiantit.

3. RSHTN-ja publikohet dhe është i hapur për publikun, në mënyrë që informacioni i tij të merret dhe të përdoret lehtësisht nëpërmjet rrugës elektronike. Informacioni duhet të jetë i pandërprerë dhe i përditësuar. Struktura e RSHTN-së përfshin të gjitha të dhënat për, të paktën, dhjetë vitet e fundit të raportuara dhe lejon zgjerimin e mëtejshëm të bazës së të dhënave për vitet në vazhdim.

KREU III

DETYRIMI PËR RAPORTIM NGA OPERATORI

1. Operatori i impiantit, që kryen një ose disa prej veprimtarive të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe tejkalon kufirin përkatës të kapacitetit, i raporton çdo vit AKM-së sasi të, për:

a) shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë të çdo ndotësi, sipas përcaktimit të shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilin është tejkalluar vlera kufi e shkarkimit, e përcaktuar në këtë shtojcë;

b) transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të rrezikshme, që i kalojnë 2 tonë në vit ose të mbetjeve jo të rrezikshme, që i kalojnë 2000 tonë në vit, për çdo veprimtari rikuperimi ose asgjësimi të tyre, me përjashtim të veprimtarive të asgjësimit përmes trajtimit në tokë dhe injektimit në thellësi, sipas përcaktimit në pikën 3, kreu III, të këtij vendimi, duke shënuar përkatësisht me R ose D kur mbetja parashikohet të rikuperohet ose të asgjësohet, si dhe lëvizjet ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme, duke shënuar emrin dhe adresën e rikuperuesit ose të asgjësuesit të mbetjeve dhe vendndodhjen e sheshit ku kryhet rikuperimi ose asgjësimi;

c) transferimet jashtë territorit të impiantit, për çdo ndotës që tejkalon vlerën kufi, të përcaktuar në shtojcën 2, kolona 1b, bashkëlidhur këtij vendimi, përmes ujërave të ndotura, që trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

2. Raporti i operatorit, sipas përcaktimit të pikës 1 më lart, shoqërohet me shpjegimin nëse informacioni bazohet në matje, llogaritje ose vlerësime të përafërta.

3. Mbetjet, që i nënshtrohen procesit të asgjësimit sipas metodës “trajtim në tokë” dhe “injektim në thellësi”, raportohen si shkarkim në tokë vetëm nga operatori i instalimit që gjeneron mbetjet.

4. Operatori i instalimit që kryen një ose disa nga veprimtaritë e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me kapacitet më të lartë se ato që përcaktohen në këtë shtojcë, i raporton çdo vit AKM-së informacionin që kërkohet në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij vendimi, në rast se ky informacion nuk i është dhënë me parë AKM-së, në zbatim pikës 1, kreu III, të këtij vendimi.

5. Operatori i instalimit raporton metodën analitike dhe/ose metodën e llogaritjes me të cilat janë përfutur të dhënat e raportuara prej tij.

6. Raporti për shkarkimet e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi, sipas përcaktimeve të pikës 1/a, kreu III, të këtij vendimi, përfshin të gjitha shkarkimet nga të gjitha veprimtaritë e zhvilluara në territorin e instalimit, të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Operatori përfshin në raport, sipas përcaktimeve në pikat 1 deri në 6, kreu III, të këtij vendimi, të dhëna për shkarkimet dhe transferimet që gjenerohen si rezultat i tërësisë së veprimtarive të planifikuara, aksidentale, rutinë dhe jorutinë. Operatori përcakton në raport, në mënyrë të posaçme, të dhënat për shkarkimet aksidentale.

8. Operatori i instalimit mbledh, sipas një frekuence periodike, informacionin e nevojshëm për të përcaktuar se cilat nga shkarkimet e instalimit dhe nga transferimet jashtë territorit të tij janë subjekt i kërkesave për raportim, sipas përcaktimeve në pikat 1 deri në 6, kreu III, të këtij vendimi.

9. Në përgatitjen e raportit, sipas përcaktimeve në pikat 1 deri në 6, kreu III, të këtij vendimi, operatori përfshin informacionin më të mirë të mundshëm, i cili mund të përmbajë të dhëna nga monitorimi, faktorët e shkarkimeve, ekuacionet e bilancit të masës, monitorimin ose llogaritjet e tjera jo

të drejtpërdrejta, vlerësime inxhinierike dhe metoda të tjera, në përputhje me pikën 1, kreu IV, të këtij vendimi.

10. Operatori i instalimit mban të dhënat që shërbejnë për raportimin për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve apo mbetjeve jashtë territorit të instalimit për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga viti i fundit kur është bërë raportimi. Në këto të dhëna përfshihet edhe metodologjia e përdorur për grumbullimin e tyre.

11. AKM-ja përcakton, për secilin nga operatorët që kërkon të ruhet konfidencialiteti i informacionit të dhënë për impiantin, nëse ky informacion është objekt i legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror, tregtar apo për ruajtjen e të dhënave personale.

12. Operatori i instalimit, në zbatim të këtij vendimi, përgatit raportin për AKM-në, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

13. Operatori i instalimit përgatit raportin për një vit kalendarik dhe e dërgon pranë AKM-së, brenda datës 1 prill të vitit pasardhës.

KREU IV SHKARKIMET NGA BURIME TË SHPËRNDARA

1. AKM-ja përfshin, në seksionin përkatës të RSHTN-së, edhe informacion për shkarkimet nga burime të shpërndara, kur ky informacion ekziston.

2. Informacioni i kërkuar në pikën 1, të këtij kreu, organizohet në mënyrë të tillë që të lejojë publikun të kërkojë dhe të gjejë lehtësisht informacion për shkarkimet e ndotësve nga burime të shpërndara, në bazë qarku, si dhe metodologjinë e përdorur për grumbullimin e të dhënave.

3. AKM-ja, kur vlerëson se të dhënat për shkarkimet e ndotësve nga burime të shpërndara mungojnë, merr masa për të filluar monitorimin e tyre.

KREU V GARANTIMI I CILËSISË, VLERËSIMI, E DREJTA E INFORMIMIT, PJESËMARRJA E PUBLIKUT DHE E DREJTA E ANKIMIT

1. Operatori i instalimit që ka detyrimin për raportim, sipas përcaktimeve në pikat 1 deri në 6, kreu III, të këtij vendimi, është përgjegjës për vërtetësinë dhe cilësinë e informacionit që raporton.

2. AKM-ja analizon dhe verifikon cilësinë e të dhënave të paraqitura nga operatori i instalimit, nëse janë të plota, të vazhdueshme dhe të besueshme, dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare të internetit, brenda 90 ditëve nga data e raportimit nga operatori, referuar afatit në pikën 13, kreu IV, të këtij vendimi.

3. AKM-ja publikon RSHTN-në në faqen e saj zyrtare të internetit, si pjesë të Sistemit të Informacionit Mjedisor, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

4. AKM-ja i siguron publikut mundësinë për të dhënë komente, informacione, analiza ose opinione lidhur me funksionimin e RSHTN-së.

5. Publiku ushtron të drejtën e ankimit, lidhur me mosrespektimin e së drejtës për të marrë informacionin mjedisor, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike në datën 1 qershor 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca 1
Lista e instalimeve që janë subjekt raportimi

Numri	Aktiviteti	Kufiri i Kapacitetit
1.	Sektori energjistik	
a.	Rafineritë e vajit mineral dhe gazit	-----
b.	Instalimet për gazifikimin dhe lëngëzimin	-----
c.	Stacionet termocentrale dhe sisteme të tjera incinerimi	Me kapacitet 50MW
d.	Furrat e koksit	-----
e.	Fabrikat e qymyrit	Me kapacitet 1 ton në orë
f.	Instalimet për prodhimin e produkteve të qymyrit dhe karburanteve solide pa tym	-----
2	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	
a.	Instalimet për përkthimin ose bashkimin pa shkërrje të xeherorëve të metaleve (duke përfshirë këtu xeherorin e sulfurit)	-----
b.	Instalimet për prodhimin e gëzës ose të çelikut të papërpunuar (shkërrja parësore ose dytësore) duke përfshirë metodën e derdhjes së vazhdueshme	Me kapacitet 2,5 ton në orë
c.	Instalimet për përpunimin e metaleve të zeza:	
a.	Fabrikat e petëzimit në të nxehtë	Me kapacitet 20 ton në orë për çelik të papërpunuar
ii.	Punishtet e hekurit (farkat) me çekiç	Me një energji prej 50 kiloxhaul për çekiç, ku fuqia kalorifike e përdorur i kalon 20 MW
iii.	Aplikimet e veshjeve mbrojtëse për metalet e shkërrja me njëra tjetrën	Me një kapacitet hyrës prej 2 ton në orë çelik të papërpunuar
d.	Fonderitë e metaleve të zeza	Me një kapacitet prodhues prej 20 ton në ditë
e.	Instalimet për metalet me ngjyra për:	
i.	prodhimin e metaleve me ngjyra të papërpunuar nga xeherorët ,përqëndrimet ose lëndë të para dytësore nga procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike	-----
ii.	shkërrjen, përfshirë aliazhet, e metaleve me ngjyra, përfshirë produktet e rikupëruara (rafinimin, derdhjet në forma në fonderi, etj)	Me një kapacitet shkërrës prej 4 ton në ditë për plumbin dhe kadmiumin ose 20 ton në ditë për të gjitha metalet e tjera
f.	Instalimet për trajtimin e sipërfaqeve të materialeve prej metali dhe plastike që përdorin një proces elektrolitik ose kimik	Ku vëllimi i kontenerit trajtues është i barabartë me 30 m ³
3	Industria e mineraleve	
a.	Minierat nëntokësore dhe operacionet e lidhura me to	----
b.	Minierat dhe gurorët në sipërfaqe	Atje ku sipërfaqja e zones efektive në operacione nxjerrëse është e barabartë me 25 hektarë
c.	Instalimet për prodhimin e:	
i.	Klinkerit të çimentos në furra rrotulluese	Me një kapacitet prodhues prej 500 tonë në ditë
ii.	Gëlqeres në furra rrotulluese	Me një kapacitet prodhues prej 500 tonë në ditë
iii.	Klinkerit të çimentos ose gëlqeres në furra të tjera	Me një kapacitet prodhues prej 500 tonë në ditë
d.	Instalimet për prodhimin e asbestit dhe manifakturimin e produkteve me bazë asbestin	----
e.	Instalimet për prodhimin e manifakturimin e qelqit, përfshirë fibrat prej qelqi	Me një kapacitet shkërrës prej 20 tonë në ditë
f.	Instalimet për shkërrjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale	Me një kapacitet shkërrës prej 20 tonë në ditë
g.	Instalimet për manifakturimin e produkteve prej qeramike nëpërmjet flakës, në veçanti tjegullat e çative, tullat, tullat refraktare pllakat, gresi ose porcelani	Me një kapacitet prodhues prej 75 tonë në ditë ose me një kapacitet furre prej 4m ³ dhe me një densitet të përcaktuar prej 300 kg/m ³ për furrrë
4	Industria kimike	
a.	Instalimet kimike për prodhimin në shkallë industriale të kimikateve organike bazë, siç janë:	
i.	Hidrokarburet e thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike)	----
ii.	Hidrokarburet që përmbajnë oksigjen siç janë	----

Numri	Aktiviteti	Kufiri i Kapacitetit
	alkoolet, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, rrëshirat epokside	
	iii. Hidrokarburet sulfurore	----
	iv. Hidrokarburet e azotit siç janë aminat, amidet, përbërjet e azotit ose përbërjet e nitrarit, nitrilet, cianuret, izocianuret	----
	v. Hidrokarburet që përmbajnë fosfor	----
	vi. Hidrokarburet halogjene	----
	vii. Përbërjet organometalike	----
	viii. Materialet plastike bazë (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze)	----
	ix. Gomat sintetike	----
	x. Ngjyruesit dhe pigmentet	----
	xi. Agjentët që veprojnë tek sipërfaqet dhe stabilizantët	----
b.	Instalimet kimike për prodhimin në shkallë industriale të kimikateve inorganike bazë, siç janë:	
	i. Gazrat, siç janë amoniaku, klori ose kloruri i hidrogjenit, fluori ose fluoruri i hidrogjenit, oksidet e karbonit, përbërjet e squfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksidi i squfurit, kloruri karbonik	----
	ii. Acidet, siç janë acidi kromik, acidi fluorhidrik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi klorhidrik, acidi sulfurik, oleum, acidet sulfurore	----
	iii. Bazat siç janë, hidroksidi i amonit, hidroksidi i kaliumit, hidroksidi i natriumit	----
	iv. Kripërat, siç janë kloruri i amonit, kloruri i kaliumit, karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, perborati, nitrati i argjendit	----
	v. Jo metalet, oksidet e metaleve ose përbërje të tjera inorganike siç janë karbitet e kalciumit, silikoni, karbitet e silikonit	----
c.	Instalimet kimike për prodhimin në shkallë industriale të plehërave kimike me bazë fosfori-, azoti- ose kaliumi (plehëra të thjeshta ose të përbëra)	----
d.	Instalimet kimike për prodhimin në shkallë industriale të produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe të biocideve	----
e.	Instalimet që përdorin një process kimik ose biologjik për prodhimin në shkallë industriale të produkteve farmaceutike bazë	----
f.	Instalimet për prodhimin në shkallë industriale të produkteve eksplozive / shpërthyesë dhe piroteknike	----
5	Manaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të përdorur	
a.	Instalimet për rikuperimin / riaftësimin ose depozitimin / asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme	Duke marrë 10 tonë në ditë
b.	Instalimet për incinerimin e mbetjeve të parrezikshme në këndvështrimin e Ligjit mbi Manaxhimin e Mbetjeve	Me një kapacitet prej 3 tonë në orë
c.	Instalimet për depozitimin / asgjësimin e mbetjeve të parrezikshme	Me një kapacitet prej 50 tonë në ditë
d.	Lendfillet (duke përfshirë lendfillet për mbetjet inerte dhe lendfillet të cilat ishin të mbyllura përfundimisht para datës 16 Korrik 2001 ose lendfillet për të cilat ka kaluar afati i kujdesit pas mbylljes siç kërkohet nga Ligji mbi Manaxhimin e Mbetjeve)	Duke marrë 10 tonë në ditë ose me një kapacitet total prej 25 000 tonë
e.	Instalimet për asgjësimin / depozitimin e skeleteve të kafshëve dhe mbetjeve shtazore	Me një kapacitet trajtimi prej 10 tonë në ditë
f.	Impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të përdorur	Me një kapacitet prej 100 000 ekuivalent popullimi (e.p.)
g.	Impjantet e trajtimit të ujërave të përdorur industriale që	Me një kapacitet prej 10 000 m ³ në ditë

Numri	Aktiviteti	Kufiri i Kapacitetit
	operojnë në mënyrë të pavarur dhe i shërbejnë një ose disa aktiviteve të kësaj Shtojcë	
6	Prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe drurit	
a.	Impjante industriale për prodhimin e brumit të letrës nga druri ose materiale fibroze të ngjashme	----
b.	Impjante industriale për prodhimin e letrës dhe kartonit dhe produkteve të tjera primare prej druri (siç janë kartoni nga letra e ricikluar, fibrat dhe kompensatat)	Me një kapacitet prodhimi prej 20 tonë në ditë
c.	Impjante industriale për ruajtjen e drurit dhe produkteve prej druri me kimikate	Me një kapacitet prodhimi prej 50 m ³ në ditë
7	Prodhimi intensiv i bagëtive dhe akuakulturës	
a.	Instalimet për rritjen intensive të:	
	i. Pulave	Me 40 000 vende për pularinë
	ii. Derrave	i) Me 2 000 vende për prodhimin e derrave (mbi 30 kg) ii) Me 750 vende për dosat
b.	Akuakultura intensive	Me një kapacitet prodhues prej 1 000 tonë peshk ose molusqe në vit
8	Produkte shtazore dhe bimore (perime) nga sektori i ushqimit dhe pijeve	
a.	Thertoret	Me një kapacitet prodhimi kafshësh të therura prej 50 tonë në ditë
b.	Trajtimi dhe përpunimi që synon prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve nga:	
	i. Lëndët e para shtazore (përveç qumështit)	Me një prodhim produkti të gatshëm prej 75 tonë në ditë
	ii. Lëndët e para bimore (të perimeve)	Me një prodhim produkti të gatshëm prej 300 tonë në ditë (vlera mesatare në baza tremujore)
c.	Trajtimi dhe përpunimi i qumështit	Me një kapacitet për të marrë 200 tonë qumësht në ditë (vlera mesatare në baza vjetore)
9	Aktivitete të tjera	
a.	Impjantet për para-trajtimin (operacione të tilla si larja, zbardhja, lustrimi) ose ngjyrosjen e fibrave ose tekstileve	Me një kapacitet trajtimi prej 10 tonë në ditë
b.	Impjantet për rregjien e lëkurave dhe peliçeve	Me një kapacitet trajtimi prej 12 tonë produkt i gatshëm në ditë
c.	Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve ose produkteve, që përdorin tretës organikë, në mënyrë të veçantë për veshjen, printimin, mbështjelljen, heqjen e yndyrnave, hidroizolimim, dhënie e përmasave, lyerjen, pastrimin ose saturimin	Me një kapacitet konsumi prej 150 kg në orë ose 200 tonë në vit
d.	Instalimet për prodhimin e karbonit (qymyrit të djegur) ose elektro-grafitit nëpërmjet incinerimit ose grafitizimit	----
e.	Instalimet për ndërtimin e, dhe lyerjen ose heqjen e bojës nga anijet	Me një kapacitet për anije 100 m të gjata

Shënim për Shtojcën 1

Në ato raste kur nuk është treguar vlera e lejuar e kapacitetit në tabelë, do të thotë se të gjitha impiantet në këtë aktivitet, pavarësisht nga kapaciteti i tyre, janë subjekt i kërkesave të këtij vendimi.

Shtojca 2
Lista e ndotësve

Shkarkimet e ndotësve që u përkasin disa kategorive ndotësish duhet të raportohen për secilën nga këto kategori.

Nr.	Numri CAS	Ndotësi ¹	Formula kimike ose shkurtimi	Vlera kufi për shkarkimet(kolona 1) ²		
				Shkarkimet në ajër (kolona 1a) kg/vit	Shkarkimet në ujë (kolona 1b) kg/vit	Shkarkimet në tokë (kolona 1c) kg/vit
1	74-82-8	Metani	CH ₄	100,000		
2	630-08-0	Monoksidi i karbonit	CO	500,000		
3	124-38-9	Dioksidi i karbonit	CO ₂	100 milionë		
4		Hidro-fluorokarburet ³	HFC	100		
5	10024-97-2	Oksidi i azotit	N ₂ O	10,000		
6	7664-41-7	Amoniaku	NH ₃	10,000		
7		Përbërjet organike të paqëndrueshme jo-metan	NMVOG	100,000		
8		Oksidet e azotit	NO _x / NO ₂	100,000		
9		Perfluorokarburet ⁴	PFC	100		
10	2551-62-4	Hekzafluori i squfurit	SF ₆	50		
11		Oksidet e squfurit	SO _x / SO ₂	150,000		
12		Azoti total			50,000	50,000
13		Fosfori total			5,000	5,000
14		Hidroklorofluorkarburet ⁵	HCFC	1		
15		Klorofluorkarburet ⁶	CFC	1		
16		Halonet ⁷		1		
17		Arseniku dhe përbërjet ⁸	As	20	5	5
18		Kadmiumi dhe përbërjet ⁸	Cd	10	5	5
19		Kromi dhe përbërjet ⁸	Cr	100	50	50
20		Bakri dhe përbërjet ⁸	Cu	100	50	50
21		Mërkuri dhe përbërjet ⁸	Hg	10	1	1
22		Nikeli dhe përbërjet ⁸	Ni	50	20	20
23		Plumbi dhe përbërjet ⁸	Pb	200	20	20
24		Zinku dhe përbërjet ⁸	Zn	200	100	100
25	15972-60-8	Alaklori			1	1
26	309-00-2	Aldrini		1	1	1
27	1912-24-9	Altrazini			1	1
28	57-74-9	Kloridani		1	1	1
29	143-50-0	Klordekoni		1	1	1
30	470-90-6	Klorfenvinofosi			1	1
31	85535-84-8	Kloro-alkanet	C ₁₀ -C ₁₂		1	1
32	2921-88-2	Klorpirifosi			1	1
33	50-29-3	DDT		1	1	1
34	107-06-2	1,2-dikloroetani	EDC	1,000	10	10
35	75-09-2	Diklorometani	DCM	1,000	10	10

Nr.	Numri CAS	Ndotësi ¹	Formula kimike ose shkurtimi	Vlera kufi për shkarkimet(kolona 1) ²		
				Shkarkimet në ajër (kolona 1a) kg/vit	Shkarkimet në ujë (kolona 1b) kg/vit	Shkarkimet në tokë (kolona 1c) kg/vit
36	60-57-1	Dieldrini		1	1	1
37	330-54-1	Diuroni			1	1
38	115-29-7	Endosulfani			1	1
39	72-20-8	Endrini		1	1	1
40		Përbërjet organike të halogjenuara ⁹	AOX		1,000	1,000
41	76-44-8	Heptaklori		1	1	1
42	118-74-1	Hekzaklorbenzeni	HCB	10	1	1
43	87-68-3	Hekzaklorbutadieni	HCBD		1	1
44	608-73-1	1,2,3,4,5,6-hekzaklorcikloheksani	HCH	10	1	1
45	58-89-9	Lindani		1	1	1
46	2385-85-5	Mireksi		1	1	1
47		PCDD + PCDF (dioksinat + furanet) (si Teq) ¹⁰		0.0001	0.0001	0.0001
48	608-93-5	Pentaklorobenzeni		1	1	1
49	87-86-5	Pentaklorofenoli	PCP	10	1	1
50	1336-36-3	Bifenilet e poliklorinuara	PCB	0.1	0.1	0.1
51	122-34-9	Simazini			1	1
52	127-18-4	Tetrakloretileni	PER	2,000	10	
53	56-23-5	Tetraklormetani	TCM	100	1	
54	12002-48-1	Triklorobenzenet (të gjitha izomeret)	TCB	10	1	
55	71-55-6	1,1,1-trikloroetani		100		
56	79-34-5	1,1,2,2-tetrakloroetani		50		
57	79-01-6	Trikloroetileni		2,000	10	
58	67-66-3	Triklorometani		500	10	
59	8001-35-2	Toksafeni		1	1	1
60	75-01-4	Klorur vinili		1,000	10	10
61	120-12-7	Anthraseni		50	1	1
62	71-43-2	Benzeni		1,000	200 si BTEX ¹¹	200 si BTEX ¹¹
63		Difenileteret e bromura ¹²	PBDE		1	1
64		Nonilfenolet dhe etoksilate e nonilfenolit	NP / NPE		1	1
65	100-41-4	Etil benzeni			200 si BTEX ¹¹	200 si BTEX ¹¹
66	75-21-8	Oksid etileni		1,000	10	10
67	34123-59-6	Izoproturoni			1	1
68	91-20-3	Naftalina		100	10	10
69		Përbërjet organokallaj (si kallaj total)	Sn		50	50
70	117-81-7	di-(2-etil hekzil) ftalati	DEHP	10	1	1
71	108-95-2	Fenolet (si total C) ¹³			20	20
72		Hidrokarburet polociklike aromatike ¹⁴	PAH	50	5	5

Nr.	Numri CAS	Ndotësi ¹	Formula kimike ose shkurtimi	Vlera kufi për shkarkimet(kolona 1) ²		
				Shkarkimet në ajër (kolona 1a) kg/vit	Shkarkimet në ujë (kolona 1b) kg/vit	Shkarkimet në tokë (kolona 1c) kg/vit
73	108-88-3	Tolueni			200 si BTEX ¹¹	200 si BTEX ¹¹
74		Tributiltina dhe përbërjet ¹⁵			1	1
75		Trifeniltina dhe përbërjet ¹⁶			1	1
76		Karboni organik total (si total C ose COD/3)	TOC		50,000	
77	1582-09-8	Trifluralina			1	1
78	1330-20-7	Ksilenet ¹⁷			200 si BTEX ¹¹	200 si BTEX ¹¹
79		Kloridet (si total Cl)	Cl		2 milionë	2 milionë
80		Klori dhe përbërjet inorganike (si HCl)	HCl	10,000		
81	1332-21-4	Asbesti		1	1	1
82		Cianuret (si total CN)	CN		50	50
83		Fluoruret (si total F)	F		2,000	2,000
84		Fluori dhe përbërjet inorganike (si HF)	HF	5,000		
85	74-90-8	Cianur hidrogjeni	HCN	200		
86		Thërrmijat	PM ₁₀	50,000		
87	1806-26-4	Oktilfenolet dhe etoksilatet e oktilfenolit			1	
88	206-44-0	Fluoroantenet			1	
89	465-73-6	Izodrini			1	
90	36355-1-8	Hekzabromobifenili		0.1	0.1	0.1
91	191-24-2	Benzo(g,h,i)perilemi			1	

Shënime për Shtojcën 2

1. Nëse nuk specifikohet ndryshe, secili nga ndotësit e specifikuar në Shtojcën 2 do të raportohet si masa totale e atij ndotësi, ose në rastet kur ndotësi është një grup substancash, si masa totale e grupit.
2. Një boshllëk në kolonë tregon se parametri dhe mesatarja në fjalë nuk përbëjnë një kërkesë raportuese.
3. Masa totale e hidro-fluorokarbureve: shuma e HFC23, HFC32, HFC41, HFC4310mee, HFC125, HFC134, HFC134a, HFC152a, HFC143, HFC143a, HFC227ea, HFC236fa, HFC245ca, HFC365mfc.
4. Masa totale e perfluorokarbureve: shuma e CF4, C2F6, C3F8, C4F10, c-C4F8, C5F12, C6F14.
5. Masa totale e substancave që përfshijnë izomerët e tyre të:

- | | | |
|--|--|---|
| a. CHFCl ₂ (HCFC-21) | n. CH ₃ CF ₂ Cl (HCFC-142b) | z. C ₃ H ₂ F ₃ Cl ₃ (HCFC-233) |
| b. CHF ₂ Cl (HCFC-22) | o. C ₂ H ₄ FCl (HCFC-151) | aa. C ₃ H ₂ F ₄ Cl ₂ (HCFC-234) |
| c. CH ₂ FCl (HCFC-31) | p. C ₃ HFCl ₆ (HCFC-221) | bb. C ₃ H ₂ F ₅ Cl (HCFC-235) |
| d. C ₂ HFCl ₄ (HCFC-121) | q. C ₃ HF ₂ Cl ₅ (HCFC-222) | cc. C ₃ H ₃ FCl ₄ (HCFC-241) |
| e. C ₂ HF ₂ Cl ₃ (HCFC-122) | r. C ₃ HF ₃ Cl ₄ (HCFC-223) | dd. C ₃ H ₃ F ₂ Cl ₃ (HCFC-242) |
| f. C ₂ HF ₃ Cl ₂ (HCFC-123) | s. C ₃ HF ₄ Cl ₃ (HCFC-224) | ee. C ₃ H ₃ F ₃ Cl ₂ (HCFC-243) |
| g. C ₂ HF ₄ Cl (HCFC-124) | t. C ₃ HF ₅ Cl ₂ (HCFC-225) | ff. C ₃ H ₃ F ₄ Cl (HCFC-244) |
| h. C ₂ H ₂ FCl ₃ (HCFC-131) | u. CF ₃ CF ₂ CHCl ₂ (HCFC-225ca) | gg. C ₃ H ₄ FCl ₃ (HCFC-251) |
| i. C ₂ H ₂ F ₂ Cl ₂ (HCFC-132) | v. CF ₂ ClCF ₂ CHClF (HCFC-225cb) | hh. C ₃ H ₄ F ₂ Cl ₂ (HCFC-252) |
| j. C ₂ H ₂ F ₃ Cl (HCFC-133) | w. C ₃ HF ₆ Cl (HCFC-226) | ii. C ₃ H ₄ F ₃ Cl (HCFC-253) |
| k. C ₂ H ₃ FCl ₂ (HCFC-141) | x. C ₃ H ₂ FCl ₅ (HCFC-231) | jj. C ₃ H ₅ FCl ₂ (HCFC-261) |
| l. CH ₃ CFCl ₂ (HCFC-141b) | y. C ₃ H ₂ F ₂ Cl ₄ (HCFC-232) | kk. C ₃ H ₅ F ₂ Cl (HCFC-262) |
| m. C ₂ H ₃ F ₂ Cl (HCFC-142) | | ll. C ₃ H ₆ FCl (HCFC-271) |

6. Masa totale e substancave që përfshijnë izomerët e tyre të:

- | | | |
|--|--|--|
| a. CFCl ₃ (CFC-11) | f. CF ₃ Cl (CFC-13) | k. C ₃ F ₃ Cl ₅ (CFC-213) |
| b. CF ₂ Cl ₂ (CFC-12) | g. C ₂ FCl ₅ (CFC-111) | l. C ₃ F ₄ Cl ₄ (CFC-214) |
| c. C ₂ F ₃ Cl ₃ (CFC-113) | h. C ₂ F ₂ Cl ₄ (CFC-112) | m. C ₃ F ₅ Cl ₃ (CFC-215) |
| d. C ₂ F ₄ Cl ₂ (CFC-114) | i. C ₃ FCl ₇ (CFC-211) | n. C ₃ F ₆ Cl ₂ (CFC-216) |
| e. C ₂ F ₅ Cl (CFC-115) | j. C ₃ F ₂ Cl ₆ (CFC-212) | o. C ₃ F ₇ Cl (CFC-217) |

7. Masa totale e substancave që përfshijnë izomerët e tyre të:

- | | | |
|--------------------------------------|---|---|
| a. CF ₂ BrCl (halon-1211) | c. C ₂ F ₄ Br ₂ (halon-2402) | d. CCl ₄ (tetrakloruri i karbonit) |
| b. CF ₃ Br (halon-1301) | | |

8. Të gjitha metalet duhet të raportohen si masa totale e elementit në të gjitha format kimike të pranishme në shkarkim.

9. Përbërjet organike të halogjenuara të cilat mund të absorbohen nga karboni i aktivizuar i shprehur si klorur.

10. Shprehur si I-TEQ.

11. Ndotësit e vetëm do të raportohen nëse vlera e lejuar për BTEX (parametri shumë e benzenit, toluenit, etil benzenit, ksilenit) është tejkaluar.

12. Masa totale e difeniletereve të bromura të mëposhtme: penta-BDE, okta-BDE dhe deka-BDE.

13. Masa totale e fenolit dhe fenolet e thjeshta të zëvendësuara të shprehura si karbon total.

14. Hidrokarburet policiklike aromatike (PAH) duhet të maten për raportimin e emetimeve në ajër si benzo(a)pireni (50-32-8), benzo(b)fluoroanteni (205-99-2), benzo(k)fluoroanteni (207-08-9), indeno(1,2,3-cd)pireni (193-39-5).

15. Masa totale e përbërjeve të tributilitinës e shprehur si masa e tributilitinës.

16. Masa totale e përbërjeve të trifenilitinës, e shprehur si masa e trifenilitinës.

17. Masa totale e ksilenit (orto-ksileni, meta-ksileni, para-ksileni).

Shtojca 3
Formulari për raportimin nga operatori të të dhënave për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve

**RREGJISTRI I SHKARKIMIT DHE TRANSFERIMIT TË
NDOTËSVE
FORMULARI PËR RAPORTIMIN E TË DHËNAVE PËR
SHKARKIMIN DHE TRANSFERIMIN**

Ministria e Mjedisit

Ky formular duhet të plotësohet nga operatori i impiantit dhe të dorëzohet ne Agjencine Kombetare te Mjedisit. Tregoni nëse informacioni është bazuar në matje, llogaritje ose vlerësime për:

- Shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë të ndonjërit prej ndotësve ose mbetjeve të listuara në rastet kur vlera e lejuar është tejkaluar
- Transferimi jashtë territorit te impiantit i mbetjeve të rrezikshme >2 tonë/vit ose mbetjeve të parrezikshme > 2,000 tonë/vit për çdo lloj operacioni rikuperimi/riaftësimi ose asgjësimi. Lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme duhet të përfshijë emrin/adresën e rikuperuesit dhe asgjësuesit, dhe vendin e rikuperimit/riaftësimit ose asgjësimit.
- Transferimi jashtë territorit te impiantit i çdo lloj ndotësi apo mbetjeje të listuar në ujërat e ndotur që shkojnë në një impiant trajtimi te ujërave të ndotur, për të cilin është tejkaluar vlera kufi
- Identifikoni çdo lloj shkarkimi aksidental të ndotësve dhe mbetjeve të listuara.

1. Emri dhe pozicioni i personit që plotëson këtë Formular

2. Viti për të cilin jepet informacioni

3. Emri dhe numri i identifikimit të impiantit

4. Emri i kompanisë me Identifikimi i impiantit

5. Rruga

6. Bashkia, Qarku

7. Kodi postar

8. Shteti

9. Kordinatat e vend-ndodhjes

10. Bazenit lumit

11. Kodi NACE(4 shifror)

12. Vëllimi i prodhimit

13. Aktiviteti ekonomik kryesor

14. Numri i instalimeve

15. Numri i punonjësve

16. Numri i orëve operative në vit

17. Hapësirë për informacion tekst ose adresë interneti dhënë nga kompania operatore ose ajo meme

18. Listoni të gjitha Aktivitetet duke përdorur numrin ID të dhënë në Shtojcen 1 (plus Kodin KPIN atje ku është i disponueshëm)

Aktiviteti kryesor Aktiviteti 2 Aktiviteti 3 Aktiviteti 4
Aktiviteti 5

--	--	--	--	--

.....vazhdoni në një fletë të veçantë po të jetë e nevojshme

19. Të dhënat e emetimeve në ajër për impiant për çdo ndotës që tejkalon vleren kufi të dhënë në Shtojcen 2. Për çdo ndotës përfshini nëse kjo është matur (M), llogaritur (L) or vlerësuar (V). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasitë për secilin ndotës. Për çdo ndotës jepni totalin (T) në kg/vit. Identifikoni si (A) shkarkimet aksidentale të çdo ndotësi në kg/vit:

Shkarkimet në ajër						
Ndotësi		Metoda		Sasia		
Nr.	Shtojca	Emri	M/L/V	Metoda e përdorur	T (total) (kg/vit)	A (aksidental) (kg/vit)
2						
						Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

20. Të dhënat e shkarkimeve në ujë për impiant për çdo ndotës që tejkalon vleren kufi të dhënë në Shtojcen 2. Për çdo ndotës përfshini nëse kjo është matur (M), llogaritur (L) or vlerësuar (V). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasitë për secilin ndotës. Për çdo ndotës jepni totalin (T) në kg/vit. Identifikoni si (A) shkarkimet aksidentale të çdo ndotësi në kg/vit:

Shkarkimet në ujë						
Ndotësi		Metoda		Sasia		
Nr.	Shtojca	Emri	M/L/V	Metoda e përdorur	T (total) (kg/vit)	A (aksidental) (kg/vit)
2						
						Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

21. Të dhënat e shkarkimit në tokë për impiant për çdo ndotës që tejkalon vleren kufi të dhënë në Shtojcen 2. Për çdo ndotës përfshini nëse kjo është matur (M), llogaritur (L) or

vlerësuar (V). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasi të për secilin ndotës. Për çdo ndotës jepni totalin (T) në kg/vit. Identifikoni si (A) shkarkimet aksidentale të çdo ndotësi në kg/vit:

Shkarkimet në tokë						
Ndotësi		Metoda			Sasia	
Nr.	Shtojca	Emri	M/L/V	Metoda e përdorur	T (total) (kg/vit)	A (aksidental) (kg/vit)
2						
						Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

22. Transferimet jashtë territorit të impiantit të çdo ndotësi që shkon në një impiant trajtimi për ujërat e ndotur në kg/vit që tejkalojnë vlerën kufi të përcaktuar në Shtojcën 2. Për çdo ndotës përfshini nëse kjo është matur (M), llogaritur (L) or vlerësuar (V). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasi të për secilin ndotës:

Transferimet jashtë territorit të impiantit të ndotësve në ujërat e ndotur						
Ndotësi		Metoda			Sasia	
Nr.	Shtojca	Emri	M/L/V	Metoda e përdorur	T (total) (kg/vit)	A (aksidental) (kg/vit)
2						
						Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

23. Listoni të gjitha transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të rrezikshme (tonë/vit) për impiant që tejkalojnë 2 tonë/vit brenda Shqipërisë, duke treguar nëse kjo gjë bëhet për rikuperim/riafitësim (R) ose asgjësim (D). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasi të për mbetjet e rrezikshme:

Transferimet jashtë territorit të impiantit, por brenda Shqipërisë, të mbetjeve të rrezikshme	
Sasia	Metoda

Sasia (tonë/vit)	Aktiviteti i trajtimit të mbetjeve (R ose D)	M/L/V	Metoda e përdorur
			Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

24. Listoni të gjitha transferimet jashtë territorit të impiantit që eksportohen **jashtë Shqipërisë** të mbetjeve të rrezikshme (tonë/vit) për impiant që tejkalojnë 2 tonë/vit, duke treguar nëse kjo gjë bëhet për rikuperim/riaftësim (R) ose asgjësim (D). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasi të mbetjeve të rrezikshme. Jepni emrin dhe adresën e asgjësuesit dhe të destinacionit të asgjësimit, për të gjitha transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të rrezikshme që eksportohen jashtë Shqipërisë:

Transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të rrezikshme në vende të tjera						
Sasia		Metoda				
Sasia (tonë/vit)	Operacioni i trajtimit të mbetjeve (R ose D)	M/L/V	Metoda e përdorur	Emri i rikuperuesit /asgjësuesit	Adresa e rikuperuesit/asgjësuesit	Adresa e vendit aktual të rikuperimit/asgjësimit
						Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

25. Listoni të gjitha transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të jo të rrezikshme (tonë/vit) për impiant që tejkalojnë 2,000 tonë/vit, duke treguar nëse kjo gjë bëhet për rikuperim/riaftësim (R) ose asgjësim (D). Përshkruani metodën e përdorur për të matur (M) ose llogaritur (L) ose vlerësuar (V) sasi të mbetjeve:

Transferimet jashtë territorit të impiantit të mbetjeve të jo të rrezikshme			
Sasia		Metoda	
Sasia (tonë/vit)	Operacioni i trajtimit të mbetjeve (R ose D)	M/L/V	Metoda e përdorur
			Vazhdoni në rreshta të tjerë nëse është e nevojshme

Vetëm për përdorim zyrtar:

Emri i Autoritetit Kompetent qe mund t'i përgjigjet pyetjeve te publikut:

Rruga

Qyteti

Numri i telefonit

Numri i faksit

Adresa e emailit

Personi i kontaktit